



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d), nenit 17, pika o), dhe nenit 40, paragrafi 40.2, pika i) të Ligjit nr. 03/L-040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008), të nenit 24 të Ligjit nr. 04/L-071, për sistemin e adresave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 29/27, dhjetor 2011) të Udhëzimit administrativ nr. 16/2019, për krijimin e listës alfabetike për emërtime të listës rezervë dhe vendosjen e tyre në regjistrin komunal të adresave, dhe të nenit 34, paragrafi 34.1, pika d) e Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-391, dt. 25.02.2010, Kuvendi i Kryeqytetit, në mbledhjen e mbajtur më 2.11.2023, merr këtë

V E N D I M

1. Miratohet ndryshimi dhe plotësimi i Vendimit për caktimin e Komisionit për rifreskimin e listës rezervë për emërtimin e rrugëve, rrugicave dhe vendeve të tjera publike në Kryeqytet, si dhe shqyrtimin e kërkesave dhe ankesave për emërtimin e rrugëve, rrugicave dhe vendeve të tjera publike në Kryeqytet, nr. 01-020/05-69249/23, dt. 3.4.2023.
2. Sipas pikës 1 të këtij Vendimi, ndryshim – plotësimi nënkupton zëvendësimin e anëtarit Veton Krasniqi, përfaqësues i Drejtorisë së Urbanizmit, ku në vend të tij caktohet anëtari Makfired Abdullahu.
3. Pjesët tjera të Vendimit nr. 01-020/05-69249/23, dt. 3.4.2023, mbesin të pandryshuara.
4. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen: Kryetari i Kryeqytetit dhe drejtoritë e tjera relevante.
5. Ky vendim hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KRYEQYTETIT
01-020/04-215599/23, më 03.11.2023

KRYESUES I KUVENDIT
Pëllumb Bajcinovci

